



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.10.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Gëzime S. Gashi B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Furnizim me dru për ngrohje**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit-632-8985-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-135 -121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Gëzime S. Gashi B.I.e dt.03.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Furnizim me dru për ngrohje**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-8985-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-135 -121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 28.09.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **28.09.2023**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.



Arsyetim

Me dt.03.10.2023, Operatori Ekonomik Gëzime S. Gashi B.L., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **"Furnizim me dru për ngrohje"**, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-8985-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-135 -121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.10.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues me dt.21.09.2023, përmes Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, ka kërkuar nga ju dokumente shtesë të cilat është dashur t'i ngarkoni në platformën e prokurimit publik deri me dt.25.09.2023.

Meqë deri me këtë datë ju nuk kenë ngarkuar në platformën e prokurimit publik dokumentet e kërkuara, Autoriteti Kontraktues konform LPP-së ka vazhduar me Operatorin ekonomik të radhës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj
Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës